



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1472 / prot.
1

Tiranë më 29.10.2021

Lënda: Dhënie mendimi për “Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit të mjetit me qëllim konvertimin”

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE TERRITORIT

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.5960/4 prot., datë 21.10.2021, me anë të së cilës dërgoni për mendim ndryshimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit të mjetit me qëllim konvertimin” (në vijim “Marrëveshja”) lutemi referojuni vlerësimit në vijim të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”).

Zyra e Komisionerit nga verifikimet konstaton që kjo Marrëveshje nuk është dërguar më parë për mendim pranë institucionit tonë, në zbatim të gërmës “a” të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”).

Nga ana tjetër, pala nënshkruese e kësaj Marrëveshje, Republika e Italisë bazuar në Vendimin nr.8, datë 31.10.2016 të Komisionerit “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, konsiderohet vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale dhe ekziston legjitimiteti i transferimit ndërkombëtar të këtyre të dhënave sipas pikës 1, të nenit 8 të Ligjit.

Sa më sipër dhe duke ju referuar përmbajtjes së tyre shitesat e propozuara në nenin 9 të Marrëveshjes vlerësohen konform Ligjit.

Së bashku me praktikën është dërguar nga ana juaj edhe *Draft/Rregullorja e Transferimit të të Dhënave Personale ndërmjet Autoriteteve Kompetente*, (në vijim “Rregullore”) që do

të nënshkruhet ndërmjet palëve. Gjatë shqyrtimit të Rregullores, konstatojmë gjithashtu, se në tërësi nga përmbajtja e saj, kjo e fundit implementon standardet më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale.

Megjithatë, do të vlerësojmë që teksti i Rregullores të ketë një shqipërim dhe njëhësim të terminologjisë së mbrojtjes së të dhënave personale.

Konkretisht, termi “*Autoritet Kontrolli*”, në të gjithë tekstin e Rregullores të zëvendësohet me “*Autoritet Mbikëqyrës*”.

- Në paragrafin e parë, ku referohet baza ligjore, togfjalëshi “*dhe nenin*” të zëvendësohet me “*dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

- Togfjalëshi, “*Të dhënat e veçanta*”, në Kreun I, germa “b” dhe në Kreun II, pika 2 të zëvendësohet me “*Të dhëna sensitive*”.

- Togfjalëshi, “*Të dhëna të zakonshme*”, në Kreun I, germa “e” të zëvendësohet me “*Të dhëna të tjera*”.

- Termi, “*Trajtimi*”, në Kreun I, germa “f”, të zëvendësohet me “*Përpunimi*”.

- Togfjalëshi, “*Transferime të mëtejshme*” në Kreun I, germa “i”, të zëvendësohet me “*Transferime tek të tretët*”.

- Togfjalëshi “*Kriteret ligjore në fuqi*”, në Kreun I, germa “k” të zëvendësohet me: “*Legjislacioni vendas në fuqi dhe Rregullorja e (BE) 2016/679*”.

- Në paragrafin 3 të Kreut III të Rregullores, togfjalëshi “*konformitetin e trajtimit të të dhënave personale*” të zëvendësohet me “*Përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale etj.*”

- Në germën “a” paragrafin 3 të Kreut III të Rregullores, mbetet e paqartë, nëse termi “*Mbajtës*”, nënkupton kontrolluesin apo subjektin e të dhënave personale.

- Në Kreun 5, fjalia me përmbajtjen: “*...për të mbuluar kostot administarive të kërkesës apo të refuzojë t'i japë udhë nëse kjo rezulton.. etj*”, të zëvendësohet me: “*apo të refuzojë atë, nëse kjo rezulton dukshëm e pabazuar apo abuzive*”.

Përfundimisht, kërkohet përshtatja e terminologjisë së përdorur në Rregullore, në përputhje me terminologjinë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Pas reflektimeve të mësipërme, vlerësojmë se edhe Rregullorja është konform Ligjit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

